



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1050/2 prot

Datë 30.04.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK
ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI SKUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË
TJERË**

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “KREATX” Sh.P.K në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur -Shërbime”, me Nr. REF-98882-03-20-2024, me objekt “Shërbimet e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së software-ve”, me fond limit 13.965.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 08.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës Sh.A.

Mbetjen të skualifikuar për arsyet e dhëna nga komisioni i vlerësimit të ofertave dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “UpTech” Sh.P.K në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues: Operatori ekonomik “KREATX” SHPK me NIPT L12121023B, me adresë: *Njësia Bashkiake nr. 5, Rruga “Tish Daija”, Kompleksi “Kika 2”, Godina 1, Shkalla 1, Zyra nr.2, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës Sh.A
Adresa: L.17 Rr.Dalip Peza, Durrës

Subjekte të interesuar: Operatori ekonomik “UpTech” Sh.P.K me NIPT M02422010H me adresë: *Rruga “E Kavajës”, Zona Kadastrale Nr.8220, Nd. 132 Kati i parë banim Nr pasurie 8/651+3-N9, Tiranë.*

Në datën 29.04.2024 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është protokolluar ankesa me nr. 1050/2024, datë 30.04.2024 dhe numër elektronik A/2024/4036, datë 29.04.2024, e operatorit ekonomik “KREATX” Sh.P.K

në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur -Shërbime*”, me Nr. REF-98882-03-20-2024, me objekt “*Shërbimet e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së software-ve*”, me fond limit 13.965.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 08.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “*KREATX*” Sh.P.K, si dhe kwrkon mbetjen të skualifikuar për arsyet e dhëna nga komisioni i vlerësimit të ofertave dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “*UpTech*” Sh.P.K në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112 pika 3 gërmat “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.*”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “*KREATX*” Sh.P.K kundërshton me anë të ankesës si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

“*Operatori ekonomik skualifikohet pasi nuk përmbush: Pika 2.4.1. te kërkesa te tjera te vecanta per kualifikim, OE nuk ka paraqitur certifikaten 27001:2017 standarti i sigurise se informacionit.*”.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret të cilat operatori ekonomik “*KREATX*” Sh.P.K pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “*UpTech*” Sh.P.K si më poshtë vijon:

“Shtojca 8

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **20 % të vlerës së së fondit të limit të përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik **për përmbushjen me sukses të kontratës, ku te shenohen vlera, afati i perfundimit te kontrates ose/dhe faturave tatimore te shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.***
- b) *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetem fatura tatimore të shitjes **të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar ne organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.***

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të disponoj Certifikatat për standardet e mëposhtme, të lëshuara nga organizma të akredituara për këtë qëllim, në përputhje me objektin e prokurimit të kesaj procedure:

- *Certifikatën ISO 9001:2015 standardi i menaxhimit te cilesise (ose ekuivalente e perditësuar)*
- *Certifikatën 27001:2017 standardi i sigurise se informacionit*
- *ISO 20000 (manaxhimi i shërbimeve IT) e cila duhet te perkoje me kategorine dhe specifiken e produkteve dhe te shërbimeve qe prokurohen.”.*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 30.04.2024

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro